

VENDIM
Nr. 575, datë 3.9.2014

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1196, DATË 3.12.2009, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË
PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN
NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR SHKODËR – HANI I HOTIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1196, datë 3.12.2009, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 3, 4 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 7 818 (shtatë mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) m², tokë truall, me vlerë 21 534 765 (njëzet e një milionë e pesëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë, për sipërfaqen 81 503 (tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e tre) m², tokë arë, me vlerë 22 199 412 (njëzet e dy milionë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e dymbëdhjetë) lekë dhe për sipërfaqen 3 253 (tre mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) m², tokë pemëtoje, me vlerë 647 347 (gjashtëqind e dyzet e shtatë mijë e treqind e dyzet e shtatë) lekë.

Vlera e përgjithshme e shpronësimit është 44 381 524 (dyzet e katër milionë e treqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e njëzet e katër) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 2 140 000 (dy milionë e njëqind e dyzet mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, sipas pikës 3, të këtij vendimi, të përballohet përkatësisht:

a) Vlera 40 452 866 (dyzet milionë e katërqind e pesëdhjetë e dy mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë, nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”;

b) Vlera 3 928 658 (tre milionë e nëntëqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë nga buxheti i vitit 2014, zëri “Detyrimet e prapambetura (detyrimet e infrastrukturës)”.

2. Në tabelën e të shpronësuarve, bashkëlidhur vendimit, të dhënat në nënndarjet nr. 153, nr. 234, nr. 276, nr. 311, nr. 317 dhe nr. 322, ndryshohen sipas tabelave që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
Autoriteti Rrugor Shqiptar
Sektori i shpronësimeve

Me ndryshimet përkatëse, nga “arë” në “truall”

Tabela e shpronësimit sipas V.K.M.-it nr.1196 datë 03.12.2009										
Nr. Shtet. V.K.M.	PRONARI			Zona Kad.	Nomeri Pasurisë	Sip. Totale	Lloji Pas.	Sip. Shpr.	Vlera (lekë)	N.R.
	Emri	Atësia	Mbiemri							
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
322	Smajl	Ali	Rexhaj	1766	1067/19	4300	Arë	680	161160	1
	Fatmir	Ali	Rexhaj							
153	Zaho		Ajkoj	3428	31/12	1837	Arë	138	56718	2
276	Margarita	Prel	Marvinaj	2220	206/2	13213	Arë	279	56916	3
311	Arben	Rrok	Popaj	3841	724/3	3265	Arë	639	138663	4
317	Pashko	Pjetër	Kokaj	1964	986	42640	Arë	1870	426360	5
234	Zenel	Uc	Burgaj	2827	1/15,	5000	Arë	330	76890	6
	SHUMA							3936	916707	

Lista nr.2

Tabela e shpronësimit sipas ndryshimit të sipërfaqeve dhe llojit të pasurisë nga "Arë" në "Truall"											
PRONARI			Zona Kad.	Nr. Pas.	Sip. Totale	Lloji Pas.	Cmimi		Diferenca e Sip. ne VKM.me sip. qe shpronësohet sipas projektit të ndryshuar	Vlera në lekë (Diferenca e vlerës së ndryshuar me vlerën e datë në V.K.M.)	shënime
Emri	Atësia	Mbiemri					Sip. Shpr.	leke (m2)			
13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24
Smajl	Ali	Rexhaj	1766	1067/19	4300	Truall	680	1637		1113160	Kont.ZVRPP
Fatmir	Ali	Rexhaj									
Zaho	Spaho	Ajkoviç	3428	31/12	8990	Truall	138	419		57822	Kont.ZVRPP
Margarita	Prel	Marvinaj	2220	206/2	13213	Truall	170	2838	109	482460	Kont.ZVRPP
Arben	Rrok	Popaj	3841	724/3	3265	Truall	639	1637		1046043	Kont.ZVRPP
Pashko	Pjetër	Kokaj	1964	986	4256	Truall	1870	772		1443640	Kont.ZVRPP
Zenel	Uc	Burgaj	2827	1/15,	5000	Truall	330	2128		702240	Kont.ZVRPP
							3827		109	4845365	

